



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO			
Oda e Infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova Chamber of nurses, midwives and other health professionals of Kosovo			
ARKIV ARCHIV ARCHIVE			
Nr. Prot Broj. prot Prot. no	Nr. i faq Br. str. No. page	OIK	Data: Datum: Date
151			02.08.2026
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA			

Oda e infermierëve, mamive dhe profesionistëve tjerë shëndetësor të Kosovës
Komora medicinskoh sestara, babica i ostalih zdravstvenih stručnjaka Kosova
The Kosovo Chamber of nurses, midwives and other health professionals

KUVENDI I ODËS SË INFERMIERËVE, MAMIVE DHE PROFESIONISTËVE TJERË SHËNDETËSORË TË KOSOVËS (OIK), në mbështetje të nenit 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, nenit 17, paragrafi 4 dhe nenit 18, paragrafi 2 të Statutit të OIK, si dhe nenit 58 të Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OIK, në mbledhjen e mbajtur më 27.02.2026, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE PËR FLETËVOTIMET

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton përmbajtjen, formatin dhe dukjen, mënyrën dhe kontrollin e shtypjes, verifikimin, shpërndarjen dhe transportin, veçoritë e sigurisë, si dhe çështje të tjera të lidhura me fletëvotimet.

Neni 2

Përkufizimet dhe shkurtesat

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat dhe shkurtesat në vijim kanë këtë kuptim:

1. **OIK** – Oda e Infermierëve, Mamive dhe Profesionistëve të tjerë Shëndetësorë të Kosovës;
2. **KQZ** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve;
3. **SKQZ** – Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
4. **KNJZ** – Komisioni i Njësisë Zgjedhore;
5. **Njësi zgjedhore** – institucioni ose struktura e përcaktuar si bazë deleguese për zgjedhje në OIK;
6. **Vendvotim (VV)** – vendi i përcaktuar për zhvillimin e procesit të votimit;
7. **Lista Votuese (LV)** – lista e votuesve të certifikuar për zgjedhje;
8. **Operator Ekonomik (OE)** – subjekti i kontraktuar për shtypjen e fletëvotimeve.

Neni 3

Llojet e fletëvotimeve

1. Për qëllim të zgjedhjeve përdoren këto lloje të fletëvotimeve:
 - 1.1. fletëvotimi për Kuvendin e OIK;
 - 1.2. fletëvotimi për organet e tjera të OIK.

Neni 4

Përmbajtja dhe përshkrimi i fletëvotimit

1. Fletëvotimi përmban:
 - 1.1. stemën e OIK dhe logon e KQZ-së;
 - 1.2. përshkrimin e llojit të zgjedhjeve dhe kornizën me ngjyrën përkatëse;
 - 1.3. emrin e njësisë zgjedhore dhe kodin përkatës;
 - 1.4. tekstin udhëzues që tregon mënyrën e votimit;
 - 1.5. hapësirën katrore për shënimin e kandidatit për të cilin votohet;
 - 1.6. numrin rendor të kandidatit, të renditur sipas rendit alfabetik;
 - 1.7. emrin dhe mbiemrin e secilit kandidat, sipas vendimit për certifikim;
 - 1.8. tiparet e sigurisë të përcaktuara me vendim të KQZ-së.

Neni 5

Detajet teknike të fletëvotimeve

1. Fletëvotimet shtypen në letër të përcaktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Ngjyra e letres dhe e shtypit është identike në të gjitha fletëvotimet.
2. Fletëvotimet, në pjesën e sipërme ose anësore, duhet të jenë të vrimëzuara nga pjesa amë, në mënyrë që të mundësohet shpëputja e lehtë e fletëvotimit gjatë dhënies së tij votuesit.
3. Fletëvotimet përmbajnë së paku një (1) veçori sigurie, e cila i mbron ato nga kopjimi ose falsifikimi. Veçoritë e sigurisë përcaktohen me vendim të KQZ-së dhe mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në, këto elemente:
 - 3.1. **Mikroshtypi** – shtypja e karaktereve, fjalëve ose modeleve grafike në madhësi shumë të vogël, të padukshme për syrin e lirë, e cila mund të identifikohet vetëm me përdorimin e zmadhuesit;
 - 3.2. **Shtypja me rreze ultraviolet (UV Print)** – vendosja e një dizajni ose shenje unike në fletëvotim, e cila bëhet e dukshme vetëm përmes përdorimit të llambës ultraviolet (UV);
 - 3.3. **Elementi mbrojtës kundër kopjimit (Anti-copy)** – element sigurie i integruar në fletëvotim, i cili, në rast të kopjimit ose riprodhimit, shfaq një shenjë ose mbishkrim dallues që tregon se fletëvotimi është i kopjuar.
4. Fletëvotimet kanë numër serik tetëshifror, i cili shtypet në pjesën amë të fletëvotimit dhe mbetet pas shpëputjes së tij. Numri serik fillon nga 00010000.
5. KQZ vendos për formatin përfundimtar të fletëvotimit, bazuar në numrin e kandidatëve të certifikuar.

Neni 6

Përgatitja dhe miratimi i fletëvotimeve

1. SKQZ përgatit dizajnin e fletëvotimeve në përputhje me specifikat teknike të miratuara.
2. Menjëherë pas certifikimit të kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje, SKQZ përgatit dizajnin përfundimtar të fletëvotimeve.
3. SKQZ sigurohet që paraqitja e të dhënave të kandidatëve, hapësira për secilin kandidat, madhësia dhe tipi i shkronjave, të jenë të barabarta dhe të njëtrajtshme.
4. Pas verifikimit të saktësisë së të dhënave, fletëvotimet miratohen nga KQZ dhe procedohen për shtypje.

Neni 7

Numri i fletëvotimeve

1. Pas certifikimit të Listës Votuese (LV), KQZ përcakton numrin e fletëvotimeve që shtypen për secilin vendvotim, si dhe numrin e fletëvotimeve rezervë.
2. Numri i fletëvotimeve të shtypura nuk mund të tejkalojë më shumë se pesë për qind (5%) të numrit të votuesve në Listën Votuese.
3. Me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve dhe ruajtjes së integritetit të procesit zgjedhor, KQZ mund të vendosë për shtypjen e më pak fletëvotimeve sesa numri i votuesve, duke siguruar gjithmonë fletëvotime rezervë.
4. Numri përfundimtar i fletëvotimeve miratohet me vendim të KQZ-së.

Neni 8

Procesi i shtypjes dhe paketimit

1. Shtypja e fletëvotimeve bëhet nga Operatori Ekonomik i kontraktuar.
2. Pas shtypjes së ekzemplarëve të parë (pre-print), SKQZ ia paraqet Kryesuesit të KQZ-së për shqyrtim formën e shtypur.
3. KQZ miraton formatin përfundimtar për shtypjen e fletëvotimeve.
4. Fletëvotimet paketohen në kuti të njëjta, të cilat mbyllen, vulosen dhe etiketohen.
5. Etiketimi përmban këto informacione:
 - 5.1. njësinë zgjedhore;
 - 5.2. kodin e njësisë zgjedhore;
 - 5.3. numrin e fletëvotimeve.

Neni 9

Mbikëqyrja dhe kontrolli

KQZ dhe SKQZ ushtrojnë mbikëqyrje dhe kontroll gjatë procesit të shtypjes dhe paketimit të fletëvotimeve.

Neni 10

Ruajtja dhe transportimi

1. Pas përfundimit të shtypjes dhe paketimit, fletëvotimet dërgohen në selinë e KQZ-së.
2. Fletëvotimet transportohen nga KQZ te KNJZ-të, sipas mënyrës dhe afateve të përcaktuara nga KQZ.
3. Për ruajtjen e fletëvotimeve në KNJZ është përgjegjës pranuesi i tyre, njëri nga anëtarët e KNJZ-së.

Neni 12

Dispozitat përfundimtare

1. Për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, vendoset me vendim të posaçëm të KQZ-së.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për zgjedhjet për Kuvendin e OIK dhe për organet e tjera të OIK, sipas nevojës.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Prishtinë, 27.02.2026

Kryetare e OIK

Nexhmije Gori

